

KONTRATË SHITJE KUOTASH


Sot, më 22 / 02 /2021 hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: Dorian Troci, i biri i Xhelalit, lindur më 08 korrik 1984, , ne Burrel, Mat, dhe banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.036782830 dhe nr.personal I40708044S

BLERËSI: Bexhet Dedja, i biri i Zeqirit , lindur më 23 gusht 1964, në Geman, Mat, dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga e Dibres, Pallati "Andi Konstruksion" shk.1 apartamenti nr.3, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.036297070 dhe nr.personal G40823048L

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "KOMSIA " shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS M07516901A. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë "ndërtime rruge ura,ujesjellesa e kanalizime etj. ". Selia e shoqërisë: fshati Selixë,Njesia Akministrative Komsia,Rrethi Mat,Qarku Diber.
- B. Shoqëria zotëron të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare për të zhvilluar objektin e saj të veprimtarisë.
- C. Shitësi është ortak me 30% i shoqërisë "KOMSIA" shpk, duke zotëruar 30 pjesë, pjemarrja 30%, vlera e kapitalit 30 leke..
- D. Shitësi dëshiron t'i shesë blerësit Bexhet Dedja 30% të vlerës së kapitalit që zotëron në shoqërinë "KOMSIA"shpk.
- E. Blerësi është i interesuar të blejë 30% të vlerës së kapitalit që shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë "KOMSIA" shpk.



F. Në përputhje me nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" shkronja b, pika 1, te ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare" (i ndryshuar), nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo kontrate e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Shitja dhe Blerja e Kuotave

1.1 Me anë të kësaj kontrate, shitësi i kalon blerësit titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, që zotëron në kapitalin e shoqërisë "KOMISIA" shpk. Të gjitha të drejtat e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat

1.2 Blerësi do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë "KOMISIA" shpk, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i plote i shitjes që blerësi do t'i paguajë shitësit për shitjen e kuotave është i barabartë me 30 leke.
- 2.2 Çmimi i shitjes do të paguhet nga blerësi në mënyrë bankare ose me lekë në dorë.
- 2.3 Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, blerësi do të jete pronari me të drejta të plota i 30% pjeseve te blera. Kalimi i kuotave nga shitësi tek blerësi dhe çdo dokument shoqëruar do të regjistrohen nga administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar prej tij; në Qendrën Kombëtare te Bisnesit.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton se:



3.1 Statusi i Shoqërisë

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 16 / 01 2020, me numër unik identifikimi NUIS: M07516901A. Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Kuotat e parëduara me Barrë

Kuotat përfaqësojnë 30% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, janë të lira nga çdo barrë dhe nuk ka asnjë marrëveshje, për të krijuar apo rënduar me barrë asnjë nga kuotat.

3.3 Pronari i ligjshëm

Shitësi deklaron dhe garanton se ai është pronari i ligjshëm i kuotave që shiten dhe gëzon të drejtën të lidhë këtë kontratë dhe t'i kalojë blerësit kuotat objekt të kësaj kontrate.

3.4 Përputhshmëria me ligjin

Shoqëria kryen dhe ka kryer aktivitet tregtar, nga data e themelimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 4

TË NDRYSHME

- 4.1 Amendamentet: Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.
- 4.2 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zevendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkoj sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 4.3 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.



- 4.4 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 4.5 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje për secilën palë dhe një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Palët pasi lexuan këtë kontratë dhe janë dakort me përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë nënshkruajnë personalisht si më poshtë.

PALËT

SHITËSI

Dorian Troci


BLERËSI


Bekir Sejdi